



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK KORÇË

Nr. 190 prot.

Korçë, më 24.02.2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të Udhëzimit Nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", Ofruesi publik i AFP-së: Qendra e Formimit Profesional Publik, Korçë ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin Instruktur me kohë të pjesshme të kursit:

1. Instruktur me kohë të pjesshme të kursit: **"Parukeri" (IEVP Pojskë)** - 1 person
2. Instruktur me kohë të pjesshme të kursit: **"Kuzhinë" (IEVP Pojskë)** - 1 person
3. Instruktur me kohë të pjesshme të kursit: **"Sipërmarrje dhe menaxhim i biznesit të vogël" (IEVP Pojskë)** - 1 person
4. Instruktur me kohë të pjesshme të kursit: **"Aftësi për punësim" (IEVP Pojskë)** - 1 person
5. Instruktur me kohë të pjesshme të kursit: **"Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike" (IEVP Korçë)** - 1 person
6. Instruktur me kohë të pjesshme të kursit: **"Gjuhë Angleze" (IEVP Korçë)** - 1 person
7. Instruktur me kohë të pjesshme të kursit: **"Aftësi për punësim" (IEVP Korçë)** - 1 person

8. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **“Aftësi digjitale niveli bazë” (IEVP Korçë)** – 1 person
9. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **“Reception”** - 1 person
10. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **“Grafik Dizajn”** - 1 person
11. Instruktor me kohë të pjesshme të kursit: **“Thurje me grep dhe makrame”** – 1 person

Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme për vendin e lirë të punës si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;
- të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës

05.03.2026

3. Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të Udhëzimit Nr. 759, datë 30.09.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar.

DREJTOR I KOMANDUAR

Adela MYTEBERI

